



VENDIM

Nr.134, Datë 11.11.2015

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 131, DATË 31.10.2015 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TE ANKANDIT TE ZYRES SE
KOORDINUAR TE ANKANDEVE PER EUROPEN JUGLINDORE
(SEE CAO)” VERSIONI 1.2**

Në bazë të neneve 16 dhe 18 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 112 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 16, pika 3 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendim Nr.21 date 18.03.09, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.11.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. mbi vendimin nr.131 datë 31.10.2015 të Bordit të ERE-s për “Miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.2 si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike;

Vendosi :

1. Në vendimin nr. 131, datë 31.10.2015 “Miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.2 “, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 2 ndryshohet : 2. Efektet juridike të zbatimit të vendimit Nr 156 Datë 01.12.2014 “Rregullat e Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO)” janë ato të përcaktuara nga SEE CAO.

b) Shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“Ankandet e kapaciteteve të interkonjeksionit për kufijtë që janë të përjashtuara sipas procedurës së SEE CAO, për pjesën e mbetur të vitit 2015, OST sh.a. duke filluar nga 31.10.2015, do t’i zhvillojë konform “Rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”, miratuar me Vendimin Nr 140, datë 22.11.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI



Votimi i Bordit te ERE-s, për

VENDIM

Nr.134, Datë 11.11.2015

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 131, DATË 31.10.2015 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TE ANKANDIT TE ZYRES SE
KOORDINUAR TE ANKANDEVE PER EUROPEN JUGLINDORE
(SEE CAO)” VERSIONI 1.2**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj
